



This project is funded by the European Union



KONKURS - Ekspert ndërkombëtar afat-shkurtër për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm, në Komponentin 3 (parandalimi i korrupsionit) në projektin Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit

Punëdhënësi: Agjencia për Integrim Europian dhe Zhvillim Ekonomik GmbH

Lokacioni: Shkup, Maqedonia e Veriut

Lloji: Angazhim afatshkurtër

Fillimi i pritshëm: Qershor 2021

Kohëzgjatja e pritshme: dy muaj në 2021

HISTORIA

Eksperti afat-shkurtër ndërkombëtar në fushën e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm në Komponentin 3 (parandalimi i korrupsionit) do të punojë si pjesë e ekipit implementues për projektin e mbështetur nga grantet e Bashkimit Europian "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" në Maqedoninë e Veriut. Projekti zbatohet nga një partneritet ndërkombëtar me përvojë i udhëhequr nga Agjencia për Integrim Europian dhe Zhvillim Ekonomik GmbH dhe tre bashkë-aplikantë – Ministria e Drejtësisë dhe Administratës e Republikës së Kroacisë, Ministria e Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Ludwig Boltzmann Institute i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut.

Objektivi i Përgjithshëm i projektit është të forcojë sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut. Projekti ka katër objektiva specifike: 1. Të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të drejtësisë për të siguruar drejtësi në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, 2. Të forcojë kapacitetet për zbatim efektiv të teknikave moderne të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar, 3. Të përmirësojë parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe 4. Të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave themelore.

Eksperti ndërkombëtar afat-shkurtër në fushën e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm në fushën e anti-korrupsionit (Komponenti 3) do të mbështesë Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Liderin e Komponentit për Komponentin 3.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Të vlerësojë nevojat për trajnim, mentorim dhe ndërtimin e kapaciteteve në fushën e komunikimit në SCPC
- Të zhvillojë një plan të propozuar të aktivitetit për forcimin e komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm brenda SCPC
- Të mentorojë dhe mbështes stafin posaçërisht përgjegjës dhe/ose të përfshirë në komunikimin e jashtëm në SCPC
- Të zhvillojë dhe drejtojë trajnime individuale dhe grupore për stafin e SCPC për aspekte të ndryshme të komunikimit, për shembull aftësitë prezantuese, teknikat feed-back, story-telling.
- Të mbështes SCPC në zhvillimin e aktiviteteve të ndërgjegjësimit.



This project is funded by the European Union



- Të ndihmojë Liderin e Komponentit për Komponentin 3 në detyrat e tij/saj.

KËRKESAT

- Rrjedhshmëri në gjuhën angleze, të shkruar dhe të folur
- Mbi 20 vjet përvojë pune si konsulent në fushën e komunikimit të brendshëm dhe/ose të jashtëm
- Të paktën 15 vjet përvojë në mentorimin e individëve në përmirësimin e komunikimit të tyre
- Të paktën 15 vjet përvojë në trajtimin e menaxherëve në fushën e komunikimit të brendshëm dhe lidrshipit
- Përvojë nga puna me institucionet e sektorit publik dhe me punonjësit
- Përvojë nga puna në projekte për ndërtimin e kapaciteteve në Ballkanin Perëndimor
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi me gojë dhe me shkrim, të ndjeshme ndaj mjedisit politik, aftësi të shkëlqyera analitike, qasje pragmatike, të menduarit strategjik dhe planifikim operacional.
- Fleksibilitet, aftësi të forta për t'u adaptuar dhe aftësi për të punuar në ekip në një mjedis potencialisht stresues nën afate të ngushta

PËRPARËSITË:

- Përvojë nga puna me çështje të lidhura me komunikimin dhe anti-korrupsionin
- Të jetë mentor i certifikuar

DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Aplikacionet duhet të dërgohen në dragan.kovacevic@aei.at (linku dërgon e-mail) deri më 21 maj 2021, duke shënuar "International Short-term Communication Expert" në titullin e email-it (subject line) dhe duke përfshirë një CV të formatit Europass në gjuhën angleze dhe një letër motivuese. Aplikacionet e dërguara pas përfundimit të afatit ose aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në një listë më të ngushtë do të ftohen për një intervistë personale.

Eksperti ndërkombëtar afat-shkurtër i komunikimit në Komponentin 3 (parandalimi i korrupsionit) do të nënshkruajë një kontratë të ofruesit të shërbimit dhe duhet të ketë një status si i vetë-punësuar. Do të jetë përgjegjësia e tij/saj e vetme të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore për vetë-punësim si dhe të mbulojë të gjitha taksat dhe tarifat e parashikuara.